



Republika e Kosovës

- Këshilli Komunal Për Siguri në Bashkësi (KKSBB)-

01.Nr. zyrtar/ 2020



Komuna e Kaçanikut

Procesverbal

Takimi i II-të dhe i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2020

Më 25.06.2020

Në takim prezantuan:

Besim Ilazi, Kryetar i Komunës

Halim Shehu, Komandant i Policisë-Kaçanik

Lulzim Uka, përfaqësues i FSK-së

Kjani Sallahu, FOJK

Fatmir Qaka, EVSB

Shemsedin Abazi-KLSP

Ramadush Osmani-Drejtör i Shërbimeve Publike dhe Emergjenca

Lirije Luta- Komiteti për Komunitete

Zahir Doda-Drejtör i DAK

Jashar Selimi-Këshilli i Prindërve

Fidaim Fazliu-Bashkësia Islame

Takimin e kryesoi Kryetari i Komunës së Kaçanikut **z. Besim Ilazi** i cili prezentoj pikat e rendit të ditës:

1. Miratimi i procesverbalit nga takimi kaluar
2. Gjendja e sigurisë në komunën e Kaçanikut
3. Identifikimi në teren dhe prezentimi i problemeve urgjente të sigurisë
4. Inicimi dhe përzgjedhja për realizimin e një projekti të sigurisë
5. Mobilizimi për parandalimin e rreziqeve të mundëshme gjat sezonit veror (zjarret, trafiku i automjeteve etj)
6. Të ndryshme

1. Miratimi i procesverbalit nga takimi kaluar

-Proces verbali u miratua nga të gjithë të pranishmit

2. Gjendja e sigurisë në komunën e Kaçanikut

-Rreth pikës së dytë të rendit të ditës komandanti i policisë tha se situata në përgjithësi gjatë kësaj periudhe ndërmjet dy takimeve ka qenë e qetë dhe stabile. Rreth situatës së sigurisë në si stacion i policisë kemi nxjerrë një raport nga 1 janari e deri më sot kur po raportojmë dhe kemi konstatuar se gjendja e sigurisë në komunën e Kaçanikut ka qenë e qetë dhe stabile. Gjatë kësaj periudhe kohore ka pasur rritje të rasteve të dukurisë së vjedhjeve ku janë evidentuar gjithësejtë 55 raste, armë mbajtje pa leje 8 raste, dëmtim prone, aksidente në komunikacion 8 raste me lëndime të lehta trupore. Gjatë pandemisë ka pasur edhe kallëzime penale për individë që nuk kanë respektuar masat e vendosura nga IKSHP. Kemi planin operativ për sezonin e verës por që sfida mundet me qenë mungesa e stafit policorë të cilët kanë marrë pushimet por që besoj se do ja dalim pasi që për shkak të rrethanave të krijuara me pandeminë nuk pritet fluks i madh i ardhjes së mërgimtarëve.

Kryetari: gjendja e sigurisë ka qenë e qetë sidomos gjat kohës së pandemisë, e kjo është meritë e qytetarëve që në përgjithësi kanë respektuar masat e vendosura nga IKSHP.

Jemi ndër komunat e para që kemi formuar Këshillin Emergjent dhe mendoj që ky këshill ka kryer punën e sajë në nivel të lartë. Menagjimi i situatës ka qenë në nivel

të duhur falë angazhimit të të gjithë anëtarëve të Këshillit Emergjent. Si këshill Emergjent më shumë jemi angazhur në ndarjen e pakove ushqimore për kategori të ndryshme dhe nuk kemi pasur asnjë ankesë për mbulimin dhe shpërndarjen e këtyre pakove. Kontribut të jashtëzakonshëm në këtë situatë kanë dhënë donatorët të ndryshëm për qka edhe i falënderoj. Në krahasim me komunat tjera ne nuk kemi pasur shumë raste të infektuar me virus COVID-19 por që kohëve të fundit në nivel vendi rastet janë rritur dukshëm dhe ne duhet të jemi syqelë për qfardo sfidë që na paraqitet.

Kjani Sallahu: Në kuptimin e ndarjes së ndihmave ka qenë i mirëseardhur ndarja e mjeteve financiare në vlerë prej 100.000 euro nga Kuvendi Komunal, por që duke mos përjashtuar edhe donatorët tjerë të cilët në formë të ndryshme i kanë kontribuar menaxhimit të situatës.

Administratorët lokalë kanë dhënë kontributin e tyre në shpërndarjen e pakove ushqimore e higjienike. Kam vërejtje në informimin e Këshillit Emergjent, i cili nuk ka qenë i shpejtë në informacione e ndonjëherë edhe nuk ka informuar fare për rastet e infektimit, duke u lënë hapësirë rrjeteve sociale të shpërndajnë informata të pasakta e tendencioze. Në Shtabin Emergjent a është biseduar vetëm për situatën e pandemisë COVID-19 apo janë trajtuar edhe çështje tjera që kanë të bëjnë me situatën e sigurisë në përgjithësi. Pyetje tjetër për Komandantin e Policisë: A ka qenë i mjaftueshëm kapaciteti i stafit policorë në menagjimin e situatës.

Kryetari: Në Këshillin Emergjent jemi marrë kryesisht me menagjimin e situatës me pandeminë por që ndonjëherë kemi trajtuar edhe çështje tjera që lidhen me sigurinë publike.

K. i Policisë: Në Këshillin Emergjent marrin pjesë aktorët e ndryshëm që janë thirrur në menagjimin e situatës por që nuk janë përjashtuar edhe tema tjera që lidhen me çështjen e sigurisë. Me staf kemi qenë të mbuluar ngase kemi pasur edhe njësi speciale nga regjioni.

Lirije Luta: Mendoj se situata e krijuar është menagjuar mirë nga Këshilli Emergjent dhe ky menagjim është vërejtur edhe tek qytetarët. Në komitetin për komunitete është diskutuar rreth shpërndarjes së informacioneve të rrejtshme nga portali „Sje Kaçanikli nëse ...”. Më intereson të dijë se a mundë të mirren masa rreth kësaj çështje.

K. i Policisë: ky portal është jo zyrtarë dhe për më mirë masa ne duhet të kemi ankues.

Kryetari: Ky portal i ka informatat e njëanshme dhe këtë gjë e bëjnë shpeshherë. Unë nuk di formë se si të sanksionohet.

Kjani Sallahu: Kjo faqe e fejsbukut është private, tendencioze, me mision të dyshimtë dhe manipuluese, por që dikush duhet të merret me të, sesa e kanë

torturuar psiçikisht opinionin publik, duke shpërndarë informata të pasakta e të pabazuara rreth pandemisë.

Shemsedin Abazi : ka ndodhë që kjo faqe e internetit ka dhënë një informacion të rrejshëm se K.F „Lepenci” për shkak të të mungesës së mjeteve financiare ka ndërprerë garat e ne si klub menjëherë kemi reaguar tek kjo faqe që ta tërhejë atë lajm .

Lulzim Uka : me sa e njohë këtë lëmi ka dy forma që munë të sanksionohen portalet e tilla : kur ka ankues dhe kur zyrtarët policorë dhe ata komunal shohin se ky portal po krijon shqetësim e pasiguri .

3. Identifikimi në teren dhe prezantimi i problemeve urgjente të sigurisë

Ramadush Osmani : Drejtoria e Shërbimeve Publike bën identifikimin e problemeve të sigurisë dhe kemi identifikuar edhe problem që nuk i përket nivelit komunal. Shembull mundë të marrim prezencën e madhe të qenëve endacak , të cilin problem vazhdimisht e kemi ngritë në nivelin qendrorë por që neglizhenca e këtij niveli por edhe të kompanive që mirren me këtë qështje ka bërë që kjo dukuri të jetë prezente akoma . Gjithashtu ne kemi identifikuar edhe përrockat të cilat gjatë të reshurave të mëdha mundë të shkaktojnë vërshime

Komandanti i Policisë : problem që ne si polici e Kosovës kemi evidentuar për rivendosjen e shenjave të komunikacionit nëpër disa rrugë , rikthimi i gjendjes së mëparshme të kamerave të sigurisë , lirim të hapsirave për parking në Bulevardin „Ismajl Raka” dhe në rrugën „Qamil Ilazi”.

Ramadush Osmani : Bulevardi „Ismajl Raka” është në planin tonë që të shtrohet me asfalt të ri ku do të mendohet edhe për parkingje të reja , e gjithashtu rruga „Qamil Ilazi” deri te banesa e madhe do të bëhet me një rrugë njëkahëshe .

Lirije Luta: unë mendoj se në këtë pikë të rendit të ditës si evidentim dhe shqetësim të jetë edhe prania e virusit COVID-19 .

Kjani Sallahu: A e ka Komuna në planin e vet andërtimin e barrierave nëpër disa rrugë. Ka nevojë për fushatë vetëdijësuese për sjelljen e qytetarëve, sidomos nxënësve, në komunikacion, por nuk duhet anashkaluar edhe fushatën vetëdijësuese për masat paraprake ndaj virusit COVID 19, i cili vazhdon të jetë në mesin tonë .

Ramadush Osmani : sa i përket pyetjes rreth barrierave në rrugë po ju njoftoj se ne si komunë kemi në planin për mirëmbajtje edhe vendosjen e barrierave në disa rrugë në modelin siq është bërë te parku i qytetit .

K.i Policisë :njësi i policisë për komunitete ka projektin e mbajtjes së ligjeratave nëpër shkolla , të cilat ligjerata shpesh i shëndrrojnë në punë praktike duke i marrë nxënësit dhe duke i mësuar ata se si të sillen në komunikacion .

Fidaim Fazliu :është për çdo lëvdatë menagjimi i situatës me pandemi nga Këshilli Emergjent . Brengosëse është përdorimi i narkotikëve nga të rinjtë në disa lokalitete të komunës tonë sidomos nga të rinjtë të moshës adoleshente .Me lirim të masave më intereson të dijë se a është e lejuar e pamja , pyetje të cilën shpesh ma bëjnë qytetarët .Në disa lokalitete e pamja po bëhet por që përgjegjësia është personale . Dukuria e qenëve endacak ka krijuar pasiguri te qytetarët ku vetëm mbrenda kësaj kohe kemi pasur dy raste kafshimi të qytetarëve , kështu që apeloj që të mirren masa ndaj kësaj dukurie . Një shqetësim tjetër që dua ta potencoj është në rrugën Bajnicë-Rakaj zhvillohet vozitje me shpejtësi të madhe dhe nuk respektohen rregullat e komunikacionit nga disa vozitës të pandërgjegjshëm .

Komandanti i Policisë:lidhur me përdorimin e narkotikëve kemi pasur raste që i kemi kapur dhe i kemi përcjellur te njësitë që mirren me këtë dukuri , ndërsa për qenët endacak është përgjegjësi e nivelit qendrorë për trajtimin e tyre .Për shkeljen e rregullave në komunikacion ne kryejmë procedurat tona nëse hasim në këso raste .

4. Inicimi dhe përzgjedhja për realizimin e një projekti të sigurisë

-Pikën e katërt të rendit të ditës Kryetari propozoi që të mbetet si opsion i hapur dhe theksoi se në këtë situatë të kemi kujdesë në menagjimin e situatës duke vetdijësuar qytetarët rreth pasojave që mundë të kenë ata nëse nuk respektojnë masat e IKSH-së.

5.Mobilizimi për parandalimin e rreziqeve të mundëshme gjatë sezonit veror (zjarret ,trafiku i automjeteve etj)

Kryetari: edhe pse nuk pritet fluks i madh i mërgimtarëve përshkak të situatës së krijuar , ne si institucion kemi marrë masa si gjithëherë masat për të menagjuar situatën për sezonin verorë duke përfshirë edhe ndërmarrjen e aktiviteteve kundër zjarreve .

Ramadush Osmani :Drejtorja e shërbimeve Publike dhe Emergjencia ka planin për parandalimin e shfaqjes së zjarreve duke bërë njoftime publike për qytetarët për kujdesë të shtuar dhe këtë e bëjmë edhe përmes web.faqës së komunës .Brengosëse është tendenca e prerjes së pyjeve përmes zjarrvënjes së qëllimshme .Gjithashtu ne kemi paraparë disa vende për parkingje siç janë stacioni i autobusëve si dhe oborrin e shkollës fillore „Emin Duraku”.

Zahir Doda: rreth problematikës së parkingjeve DAK do të vë në dispozicion të gjitha hapsirat e jashtme të shkollave nëse është e nevojshme .

6.Të ndryshme

Kjani Sallahu : A ka qyteti hidrantë të ujit?

Ramadush Osmani : nëpër rrugë të qytetit me sa e di unë nuk ka hidrante por që objektet publike i kan të stërvjetruara . Hidrantet duhet të jenë jashtë zonës urbane që do të jet një lehtësim për shërbimin e zjarrëfikësve për tu furnizuar me ujë .Sa për informim shumë shpejtë i tërë sistemi i ujsjellësit do të kaloj nën kompetencat e Kompanisë së ujit .

Kjani Sallahu: Në këtë kohë kur edhe pishinat kanë filluar punën, duhet që të kontrollohet puna e tyre rreth cilësisë së ujit dhe a funksionojnë ekipet e shpëtimit nëpër këto pishina. Sugjeroj që komuna të jetë më kategorike ndaj personave dëmtues të pyjeve, zjarrvënjeve të qëllimshme e gjithashtu të mendohet në zgjerimin e rrjetit të ndriçimit nëpër disa lagje të qytetit dhe lokalitete.

Ramadush Osmani:sa i përket ndriçimit publik ne jemi duke punuar në zgjerimin e këtij rrjeti edhe jashtë zonës urbane por që jemi duke menduar që të bëjmë një orarë të caktuar në disa pjesë të qytetit .

Lulzim Uka :sugjeroj që komuna duhet të bëjë një planifikim në rast se situata me pandeminë bëhet më e rëndë .Duhet të planifikohet nevoja për tenda e kontanjera nëse paraçitet nevoja dhe për këtë ju mund të drejtoheni në FSK .Është mirë që raportin e menagjimit të pandemisë të na e përcillni edhe në FSK me qëllim që të jemi të njoftuar me nevojat që ka komuna .

Kjani Sallahu: Hekurmbledhësit nga Shqipëria edhe në kohë të pandemisë kanë qenë presentë edhe në komunën tonë. Rreziku nga ata ka qenë në përhapjen e virusit, ngase kanë qenë jashtë çdo kontrolli. Në situatë të zakonshme, grumbullimi i hekurit me pagesë ka prodhuar edhe hajni të ndryshme të materialeve me vlerë, prandaj edhe për faktin se ekzistojnë depot e grumbullimit të hekurit, ky aktivitet informal duhet të ndërpritet nga organet kompetente. Kjo sepse I shpëtojmë infektimit të mundshëm me COVID 19, por edhe evitohen hajnitë e ndryshme. Një çështje problematike është edhe Tregu i Gjelbërt . Do të ishte mirë që ky treg të zhvendoset te parkingu i Shoqatës së Invalidëve të Luftës ose te hapësirat e stacionit të autobusëve. Në këto kushte si funksionon tregu tani: në pluhur, në baltë, në gurë dhe pa asnjë infrastrukturë për shitjen e bylmetit, pemëve e perimeve, etj., ky treg do të duhej të mbyllej që moti. Aktivitetet e motoristëve duke zhvilluar shpejtësi të madhe dhe zhurmë të krijuar po shfaqin rrezik dhe pakënaqsi tek qytetarët. A ka ndonjë rregull të funksionimit të tyre. Në fshatin Biqec tri herë radhazi në një shtëpi ka ndodhë vjedhje dhe më intereson të dijë se a ka policia informacione rreth këtij rasti dhe a I ka zbuluar personat. Është shumë shqetësuese që e njëjta familje të plaçketet tri here, q' përveç dëmeve materiale, i ka traumatizuar pleqtë dhe fëmijët.

Komandanti i Policisë : Me hekërmbledhësit të ardhur nga jashtë është një njësit i policisë që mirret me trajtimin e tyre por që rastet e vjedhjeve duhet raportuar .Klubi i motorristëve kan aktivitetet e tyre në data të caktuara por ndonjëherë aktivitetet e tyre i zhvillojnë edhe jashtë këtyre datave . Në shumicën e rasteve ata na njoftojnë por ndodhë që ndonjëherë nuk ka njoftim rreth aktivitetit të tyre .

Kryetari : Sa i përket qështjes së tregut të gjelbërt ne si komunë nuk kemi hapsirë të mjaftueshme për zhvendosje .Parkingi i shoqatës së Invalidëve të Luftës është i paraparë parking për te palestra ndërsa hapsira e stacionit të autobusëve nuk mendoj se është vend i qëlluar për treg .Ne jemi duke menduar për një hapsirë të përkohshme por që qështja është se nuk ka hapsirë për momentin për një treg të gjelbërt të përhershëm .

Ramadush Osmani :Mendoj se tregjet tradicionale janë në zhdukje e sipër dhe ne duhet të mendojmë për tregje ditore .

REKOMANDIMET:

1. Të mirren masa rreth parandalimit të mëtutjeshëm të virusit COVID-19
2. Të mirren masa ndaj portaleve që nxixsin urretje dhe japin informata të rrejshme
3. Të ju tërhiqet vërejtje për neglizhencë të punës kompanive që mirren me trajtimin e qenëve endacak
4. Institucionet të jenë në gadishmëri të plotë në parandalimin e zjarreve
5. Të hulumtohet hapsirë për tregun e gjelbërt
6. Të mirren masa rigoroze ndaj dëmtuesve të pyjeve
7. Të rregullohen hidrante ujore jashtë zonës urbane
8. Të monitorohet aktiviteti i pishinave
9. Të bëhet zgjerimi i rrjetit të ndriqimit public edhe jashtë zones urbane
10. Angazhim më i madh në parandalimin e dukurisë së vjedhjeve
11. Të ipen informata më të shpejta nga institucionet rreth menaxhimit të situatave të ndryshme
12. Të mirren masa ndaj organizatorëve të aktiviteteve që nuk njoftojnë paraprakisht për aktivitetitn e tyre .


Pas këtyre diskutimeve Kryetari mbylli takimin për tu takuar në terminin e radhës .

Kaçanik 25.06.2020

Procesmbajtës:

Kryesuesi: Kryetari i Komunës

Besim Ilazi



Procesmbajtës

Fatmir Qaka

